REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
SEKTOR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT

Nr. 2419 prot

Maliq, më 22/04/2026

PROJEKT–VENDIM - NR 9

PËR LEHTËSIMIN E PËRKOHSHËM NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E TAKSËS SË TOKËS BUJQËSORE PËR FAMILJET BUJQËSORE, TOKA E TË CILAVE ËSHTË E PËRMBYTUR DHE E PAMUNDUR PËR T'U SHFRYTËZUAR GJATË VITIT BUJQËSOR 2026 NGA DËMTIMET E FORCAVE MADHORE TË NATYRËS

Në mbështetje të: ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,neni 8,pika 2,neni9,pika 1,nënpika 1.1,gërma"b",neni 64,"kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë",pika c.ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;neni21,pika5,gërma (b).I propozojmë Këshillit Bashkiak Maliq.

1. Lehtësimin e përkohshëm në masën 75% nga detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet bujqësore,sipas listës bashkëlidhur, toka e të cilave është e përmbytur nga rreshjet e muajve nëntor 2025-janar 2026, dhe është e pamundur për t'u shfrytëzuar gjatë vitit bujqësor 2026.
2. Lehtësimi i përkohshëm në masën 75% nga detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore, do të jetë i vlefshëm vetëm për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi,ngarkohet Sektori i Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

	(Emër Mbiemër)	(Nënshkrim)	(Data)
Konceptoi :	E.Pino		Dt.22/04/2026
Miratoi :	A.Zenunllari		Dt.22/04/2026

KRYETAR I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTOR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT

2419

Nr.____prot **Maliq, më 22/04/2026**

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN

PËR LEHTËSIMIN E PËRKOHSHËM NË MASËN 75% NGA DETYRIMI PËR PAGESËN E TAKSËS SË TOKËS BUJQËSORE PËR FAMILJET BUJQËSORE, TOKA E TË CILAVE ËSHTË E PËRMBYTUR DHE E PAMUNDUR PËR T'U SHFRYTËZUAR GJATË VITIT BUJQËSOR 2026 NGA DËMTIMET E FORCAVE MADHORE TË NATYRËS

Në mbështetje të: ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,neni 8,pika 2,neni9,pika1,nënpika1.1,gërma"b",neni64,"kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë",pika c.ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;neni21,pika5,gërma (b).

Si pasojë e reshjeve intensive dhe problematikave në sistemin e kullimit, një pjesë e konsiderueshme e tokave bujqësore në territorin e Bashkisë Maliq rezultojnë të përmbytura dhe të papërshtatshme për mbjellje gjatë vitit bujqësor 2026.

Kjo situatë ka sjellë vështirësi të mëdha ekonomike për familjet fermere, të cilat e kanë të pamundur të sigurojnë të ardhura nga aktiviteti bujqësor. Në këto kushte, detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore përbën një barrë shtesë të pajustifikuar.

Për këtë arsye, propozohet lehtësimi i përkohshëm në masën 75% nga kjo taksë, si një masë lehtësuese dhe mbështetëse për komunitetin bujqësor të prekur.

PROPOZUESI:

Sektori i Bujqësisë dhe Ushqimit

	(Emër Mbiemër)	(Nënshkrim)	(Data)
Konceptoi :	E.Pino		Dt.22/04/2026
Miratoi :	A.Zenunllari		Dt.22/04/2026

KRYETAR I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ